

SYLLABUSI I KURSIT

Të dhëna bazike të lëndës	
Njësia akademike:	Fakulteti i Edukimit
Titulli i lëndës:	Bazat e shkencave natyrore me metodologji 2
Niveli:	BA
Statusi lëndës:	O
Viti i studimeve:	III
Numri i orëve në javë:	3+2
Vlera në kredi – ECTS:	6
Koha / lokacioni:	
Mësimdhënësi i lëndës:	Prof. Asoc. Dr. Zeqir Veselaj, Asistent: MSc Zenel Krasniqi
Detajet kontaktuese:	Tel. 038 229021 E mail: Zeqir.veselaj@uni-pr.edu ze.krasniqi@hotmail.com
Përshkrimi i lëndës	<p>Bazat e shkencave natyrore me metodologji 2, është kurs që i dedikohet studentëve që përgatiten për mësimdhënës klasor për t'i njohur me jetën e gjallë në përgjithësi, karakteristikat themelore, organizimin dhe funksionimin e saj në të vetmin planet ku ajo dihet se ekziston deri sot.</p> <p>Kursi do të trajtoj njohuritë shkencore të jetës së gjallë nisur nga aspektet citologjike, histologjike, organike, fiziologjike, ekologjike, gjenetike dhe evolutive të qenieve të gjalla të përcjella edhe me komponentën metodologjike dhe didaktike për mësimdhënie efektive. Kursi do t'i njoh studentët edhe me strategjitë më të mira të mësimdhënies së shkencës biologjike tek fëmijët e nivelit fillor.</p>
Qëllimet e lëndës:	<p>Qëllimet kryesore të kursit janë:</p> <ul style="list-style-type: none"> - Njohja me jetën dhe organizimin dhe funksionimin e saj nga niveli subqelizor e deri te biosfera si tërësi, - Strukturimi i botës së gjallë dhe klasifikimi i organizmave në mbretërit kryesore të botës së gjallë, - Kompleksiteti i funksionimit të jetës së gjallë bimore, shtazore dhe asaj humane, - Proceset e riprodhimit dhe zhvillimi të bimët, shtazët dhe njeriu, - Krijimi dhe evolucionin i formave të jetës së gjallë dhe ngjarjet kryesore në evolucionin e botës së gjallë

	<ul style="list-style-type: none"> - Marrëdhëniet e organizmave të gjallë me mjedisin e jashtëm dhe me njëri tjetrin si dhe kërcënimet kryesore sot për botën e gjallë. 		
Rezultatet e pritura:	<p>Pas kompletimit të kursit studenti do të në gjendje të:</p> <ul style="list-style-type: none"> - njeh dhe aplikoj metodologjitë bashkëkohore të njohjes së botës së gjallë; - kuptoj nocionet dhe karakteristikat kryesore të jetës së gjallë dhe rregullshmërinë e organizimit dhe funksionimit të saj; - identifikoj dhe interpretoj mbretëritë e organizimit të botës së gjallë dhe karakteristikat dalluese të tyre; - përcaktoj sistemet dhe funksionet bazë që karakterizojnë dhe mbajnë jetën e gjallë të njeriut, bimëve dhe shtazëve përmes sistemeve të organeve të tyre; - vlerësoj etapat dhe ndryshimet kryesore në krijimin dhe zhvillimin evolutiv të qenieve të gjalla; - analizoj dhe kuptoj kompleksitetin e marrëdhënieve të organizmave të gjallë me mjedisin rrethues dhe ndikimin e faktorëve ekologjik për jetën e tyre në ekosistem; - aplikoj strategjitë dhe metodat për mësidhënien shkencore të botës së gjallë për nivelin fillor. 		
Kontributi në ngarkesën e studentit (gjë që duhet të korrespondoj me rezultatet e të nxënit të studentit)			
Aktiviteti	Orë	Ditë/javë	Gjithësej
Ligjërata	3	15	45
Ushtrime praktike	2	15	30
Kontaktet me mësimdhënësin/konsultimet	1	15	15
Kollokfiume, seminare	2	2	4
Detyra të shtëpisë	1	15	15
Koha e studimit vetanak të studentit (në bibliotekë/ në shtëpi)	2	15	30
Përgaditja përfundimtare për provim	5	3	15
Koha e kaluar në vlerësim (teste, provim final)	3	3	9
Projektet, prezentimet ,etj	1	5	5
Totali			168
Metodologjia e mësimdhënies:	<p>Leksion i avansuar, diskutime mbi materialin studimor ,punë praktike në laborator dhe terren, punë individuale, detyra seminarike në grupe, metoda ndërvepruese të mësimdhënies. Vizitë studimore ne Parkun e Gërmisë për zbatimin e mësimin në natyrë.</p>		

Metodat e vlerësimit:	<p>Vlerësimi është formativ dhe bëhet përmes këtyre hapave:</p> <p>Vlerësimi i parë intermedier-----15%</p> <p>Vlerësimi i dytë intermedier-----15%</p> <p>Vlerësimi i punës praktike (kusht për provimin teorik)-----10%</p> <p>Portfolio e studentit-----10%</p> <p>Detyra seminarike individuale/grupore-----5%</p> <p>Angazhimi në klasë-----5%</p> <p>Testi final----- 50%</p>
	<p style="text-align: right;">Pikët (%) Nota</p> <p style="text-align: right;">95 -100-----10</p> <p style="text-align: right;">85 – 94----- 9</p> <p style="text-align: right;">75 – 84----- 8</p> <p style="text-align: right;">65 – 74----- 7</p> <p style="text-align: right;">55 – 64----- 6</p>
	<p>Sqarim:</p> <p>Vlerësimet intermediere- Vlerësimi i parë intermedier mbahet pas javës së 5 të ligjëratave. Vlerësimi i dytë intermedier mbahet pas javës së 10 të ligjëratave.</p> <p>Nëse studenti humb dy (2) vlerësimet intermediere dhe pjesën praktike e humb të drejtën e hyrjes në provim për vitin akademik përkatës.</p> <p>Detyra seminarike në formë projekti dorëzohet në fund të semestrit për vlerësim nga mësimdhënësit e lëndës.</p> <p>Pjesa praktike e provimit është pjesë e vlerësimit final (me pikë) dhe parakusht që studenti t'i nënshtrohet provimit teorik të mësimdhënësi i lëndës.</p> <p>Portfolio e studentit- përfshin materialet e kursit të studentit në një dosje: ligjëratat, prezantimet PP, fletoren e punës në ligjëratë, fletoren e punës së pjesës praktike, punët seminarike e individuale dhe çdo elemente tjetër të realizuar nga studentit në realizimin e kursit.</p> <p>Angazhimi në klasë: secili student do të vlerësohet deri 5 pikë gjatë ligjëratave sipas angazhimit dhe aktivitetit në klasë.</p> <p>Pikët nga pjesa formative e vlerësimit (vlerësimet intermediere, projekti dhe praktika) vlejnjë vetëm brenda tri (3) afateve të provimit.</p> <p>Plagjiatura dhe kopjimi gjatë fazave të vlerësimit do të sanksionohet sipas dispozitave të Statutit të UP-së dhe Rregullores së studimeve të Fakultetit.</p>
Literatura	
Literatura bazë:	Veselaj Z. 2016 Biologjia- studimi i jetës, Dispencë me ligjëratat të autorizuara
Literatura shtesë:	<ul style="list-style-type: none"> - Papristo A. 2016 “Metodologjia e mësimdhënies së Biologjis” Universiteti i Tiranës, Tiranë - Musai B. 2008 “ Mësimdhënia dhe të nxëniet ndërveprues” Biologji, CDE, Tiranë - Beadini N. 2003 “Citologjia” Universiteti i Tetovës, AZA-EOsoft, Tetovë - Kaskel A. Hummer Jr. P., Lucy D. 1988 “Biology- an everyday experience” Merril Columbus, Ohio Miho A. Topuzi L., Marka J. 2008 “Botanika e përgjithshme” SHB. Julvin 2, Tiranë - Miho. A. Shuka L. 2005 “Fiziologjia e bimëve” SHB P.S.H. 2015, Tiranë

	<p>ISBN 99943-784-0-6 Peja N. 2006 “Ekologjia” Shtëpia Botuese P.S.H 2015, Tiranë, ISBN 99927-0-034-3 Marinkovic. D. 1987 “Gjenetika” përkthim. ETMMK, Prishtinë Veselaj Z. 2009 “ Biodiversiteti” Universiteti i Prishtinës dhe WUS Austria, Prishtinë Abdul A., Alikaj V. 2010 “ Atlas i anatomisë”, Albas Tiranë Colombo L. Atlas: Zbulu trupin e njeriut (përkthim nga Muci V.), Arba Editions, Tiranë</p>
Plani i dizajnuar i mësim:	
Java	Ligjërata që do të zhvillohet
Java 1	Prezantimi i Syllabusit dhe hyrje në lëndë: Çka është jeta dhe origjina e saj. Biologjia dhe studimi i jetës. Historiku i zhvillimit të mendimit biologjik në botë.
Java 2	Metodologjia e studimit njësisë themelore të jetës Qeliza- njësi themelore e jetës, evolucioni dhe organizimi i saj. Qeliza bimore dhe shtazore. Riprodhimi i qelizës dhe zhvillimi (mitoza dhe mejoza)
Java 3	Metodologjitë e klasifikimit të botës së gjallë Mbretëritë kryesore të botës së gjallë: Monera (prokariotët) dhe Protista (eukariotët). Kërpuhat (Fungi)- mbretëri ne vete.
Java 4	Metodologjia e njohjes së Bimëve (Mbretësia Plantae) dhe shtazëve (Mbretëria Animalia) Bimët (Plantae) - ndarjet kryesore Karakteristikat themelore të shtazëve. Shtazët e thjeshta dhe ato të përbëra. akurizorët dhe kurrizorët. Invertebrorët dhe vertebrorët
Java 5	Metodologjia e njohjes së sistemeve të organeve që mbajnë jetën <i>Sistemi i tretjes:</i> marrja, zbërthimi dhe absorbimi i ushqimit. Ushqimi dhe kalorite. <i>Sistemi i frymëmarrjes.</i> Mushkëritë dhe shkëmbimi i gazeve në organizëm. <i>Sistemi urinar-</i> veshkët dhe nxjerrja e mbetjeve.
Java 6	Metodologjia e njohjes së sistemeve të organeve që mbajnë jetën <i>Sistemi i qarkullimit të gjakut-</i> zemra, enët e gjakut dhe gjaku-lëngu i jetës. <i>Sistemi lokomotor-</i> Skeleti me eshtrat. Muskujt dhe funksioni.
Java 7	Metodologjia e njohjes së sistemeve të organeve kontrollojnë jetën Sistemi nervor- truri, palca nervore dhe nervat. Sistemi endokrin dhe gjëndrrat. Shqisat tek njeriu dhe shtazët tjera.
Java 8	Metodologjia e njohjes së sistemeve të organeve që vazhdojnë jetën- Riprodhimi dhe zhvillimi tek shtazët Riprodhimi joseksual dhe seksual te shtazët. Zhvillimi dhe metamorfozat tek shtazët. Riprodhimi te njeriu
Java 9	Metodologjia e njohjes së indeve dhe organeve vegjetative bimore <i>Indet bimore (histologjia).</i> Sistemi për përforcim dhe absorbim (rrënja). Sistemi për transport të materieve ushqyese (kërçelli).

	Sistemi fotosintetik (gjethi).
Java 10	Metodologjia e njohjes së riprodhimit dhe zhvillimit tek bimët: Riprodhimi aseksual dhe format e tij tek bimët. Riprodhimi seksual: lulja, polenizimi, pllenimi fryti dhe fara. Zhvillimi i bimës së re nga fara.
Java 11	Faktorët ekologjik dhe përgjigja e bimëve, rritja dhe sëmundjet e tyre Faktorët për rritjen e e bimëve: uji, drita, temperature dhe substrati. Hormonet bimore dhe tropizmat. Sëmundjet e bimëve.
Java 12	Rregullat e trashëgimisë te organizmat e gjallë- gjenetika ADN dhe kromozomet. Gjenet dhe rregullat e trashëgimisë (puna e Mendelit). Gjenetika humane
Java 13	Metodologjia e njohjes së evolucionit të botës së gjallë Ndryshimet në qeniet e gjalla dhe evolucioni. Adaptimet dhe seleksionim natyror- mekanizmi i ekzistencës. Darwini dhe teoria e tij për evolucionin.
Java 14	Organizmat e gjallë dhe mjedisi i jashtëm Ekologjia dhe faktorët ekologjik. Nivelet e organizimit ekologjik. Qarkullimi i materies dhe energjisë në ekosistem. Zinxhirët trofik dhe piramidat ushqyese në ekosistem.
Java 15	Llojshmëria e jetës në tokë- Biodiversiteti Kuptimet themelore dhe vlerat e biodiversitetit. Nivelet e organizimit dhe studimit të biodiversitetit. Speciet e rrezikuara, endemike dhe relikte. Zonat e mbrojtura natyrore dhe biodiversiteti i Kosovës.

Politikat akademike dhe rregullat:

Vijimi i rregullt në ligjërata dhe ushtrime është i obliguar. Hyrja me kohë në ligjërata. Pas hyrjes së profesorit në klasë nuk lejohet hyrja dhe pengimi i mësimit. Mungesa në vijimin ligjeratave dhe sjelljet në kundërshtim me etikën akademike do të sanksionohen sipas dispozitave te Statutit te UP-së dhe Rregullores së Studimeve.
Rregullat e mirësjelljes si: mbajtja e qetësisë në mësime, shkyçja e telefonave celular etj.